



Në vijim do tu ofrojmë

disa vepra të mira fetare, të cilat përveç shpërblimeve besimtarit i sjellin edhe furnizim të begatshëm.

### 1. Lidhjet farefisnore

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë:  
" ??? ????? ?? ?????? ??? ? ???? ? ????????? ???? ?? ?????? ? ????????? ????????? ". ????????

"Kush dëshiron t'i zgjerohet furnizimi dhe t'i shtohet ymri, le të kujdeset për lidhjet farefisnore".  
(Buhariu).

### 2. Bërja e Haxhit dhe Umres një pas një

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë:  
" ?????????? ??? ?????? ????????? ? ????????? ????????? ????????? ????????? ". ????????  
"Bëni Haxhin dhe Umren një pas një, sepse kjo vepër eliminon varfërinë dhe gjynahet".  
Tirmidhiu, sahih.

### 3. Sadakaja

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë:  
" ??? ?????????? ??????? : " ?? ??? ???? ! ?????? ? ??? ???? ". ????  
"Allahu, tebareke ve tealala, thotë: o njeri jep që Unë të jap ty". Muslimi

### 4. Istigfari, kërkimi i faljes.

(????????? ?????????????? ??????????). ??? (10) ... (????????????????? ??????????????). ??? (12)  
"Thash: kërkoni falje nga Zoti juaj". (Nuh: 10).  
"Ua shton pasurinë". (Nuh: 10).

### 5. Mbështetja në Allahun

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë:

" ????? ?????????? ?????????????????? ?????? ?????????? ?????? ??????????????  
????????????????? ?????? ?????????? ?????????????? ". ????? ?????????? ?????? ??????????"

"Poqë se i mbështeteni Allahut me mbështetje të vërtetë, do t' ju furnizonte ashtu sikur furnizon shpezët". Ahmed i dhe Tirmidhiu, sahih sipas shejh Albanit.

### 6. Përmbledhje e tërë këtyre veprimeve është devotshmëria

(????????? ?????? ?????????? ?????????????? ?????????? ?????????????????? ??????????????????  
????????????????? ?????????????? ?????? ?????????????????? ??????????????????) ?????????? (96)

Allahu, subhanehu ve teala thotë:

"Po sikur banorët e vendbanimit të kishin besuar dhe të ishin të devotshëm, do t'ua hapnim bereqetet nga qielli e toka...". (El-A'raf: 96).

**Bekir HALIMI**